

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALE**

**KOORDINATORI I INTEGRITETIT**

RAPORT MONITORIMI  
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT  
TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Viti 2023

## **Tabela e përmbajtjes**

---

**Përbledhje Ekzekutive**

**Qasja vlerësuese**

**Metodologjia e monitorimit**

**Gjetjet e raportit**

**Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri**

**Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri**

**Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun**

**Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar**

**Objektivi 5: Përmirësimi i efikasitetit transparencës dhe llogaridhënieς në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale**

**Konkluzione dhe rekomandime**

**Hapa të tjera**

**Aneks**

## Listë e shkurtesave

AB	Auditi i Brendshëm
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BNJ	Burime Njerëzore
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DMBNJ	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
EMP	Ekipet e Menaxhimit tw Programeve
GIZ	German Development Cooperation Office – Zyra Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
K-I	Konflikti i Interesave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
IPA	Instrument Pre-accession Assistance
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PT	Platforma e Transparencës
PSV	Proceset Standarde të Veprimit
QKUM	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
SP	Sekretari i Përgjithshëm
SEED	South East European Development - Qendra e Zhvillimit të Europës Juglindore
SQDNE	Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
RIA	Regulatory Impact Assessment - Vlerësimi i Ndikimit Regulator
RSH	Republika e Shqipërisë
TIK	Teknologji Informacion Komunikim

USB	Universal Series Bus – Memorie e jashtme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Regullator
PKIE	Plani Kombëtar i Integrimit European

## Përbledhje Ekzekutive

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale harton politika dhe programe që do të përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe do të ulin nivelin e korruptionit.

Integriteti është me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e institucioneve publike, transparente dhe të përgjegjshme. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e angazhuar për forcimin e parimeve etike të administratës publike, nëpërmjet rritjes së transparencës dhe llogaridhëniec në institucion. Plani i Integritetit, të rishikuar me Urdhërin nr. 676, datë 09.11.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, trajton çështje të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit në institucion, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregulator dhe politik të integritetit, zhvillimit të burimeve njerëzore me synim krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit. Rishikimi i Planit të Integritetit të MSHMS 2022-2025, konkretisht shtimi i disa masave/aktiviteteve si pjesë përbërëse e tij (1/1; 1/2; 6/1; 18/1 dhe 18/2), në kuadër të Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO dhe shkressës me Nr. 1363/7 protokolli, datë 04.07.2023, dërguar nga Ministria e Drejtësisë, rishikimi i një mase (41) dhe afateve për disa masa/aktivitete të tjera, u realizua nga grupi i punës në zbatim të Urdhrit Nr. 601, datë 13.09.2023, të Zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2022-2025, të rishikuar, është një instrument anti-korrupsion, që ofron kuadrin politik dhe rregulator për të forcuar rezistencën institucionale ndaj rreziqeve të integritetit dhe parashikon masa të identifikuara në fushat e përgjegjësisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit i rishikuar përmban 42 masa të karakterit rregulator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e përbajtjes së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2025.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *janar - dhjetor 2023*, është i treti dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit. Në përputhje me pikën 3 të Planit të Integritetit të MSHMS, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar raportin e monitorimit mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti i monitorimit *janar - dhjetor 2023* për zbatimin e Planit të Integritetit, jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të MSHMS, për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre. Gjithashtu raporti përmban të dhëna për veprimtarinë operacionale të njësive (drejtorive) të brendshme kontribuese, referuar publikimit dhe plotësimit të kuadrit rregulator të brendshëm, marrjen e masave për konsolidimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe profesionale të ministrisë, rritjes së transparencës në ndarjen e të dhënavë me publikun, përmirësimit të sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar dhe përmirësimit të efikasitetit, transparencës dhe llogaridhëniec në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.


Për periudhën *janar - dhjetor 2023*, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 31 masa masa/aktivitete, sipas aneksit bashkëlidhur raportit dhe janë të shpërndarë në 5 (pesë) objektivat e planit,

përkatësisht:

- Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregulator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri;
- Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri;
- Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;
- Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar;
- Objektivi 5: Përmirësimi i efikasitetit transparencës dhe llogaridhënieve në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Në këto masa përshkruhen 44 aktivitetet që duhet të zbatohen për parandalimin, zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve të integritetit, jepen afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tyre, për konsolidimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e tyre, si dhe transparencën dhe llogaridhëni të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

## ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT



Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 31 masash, janë zbatuar 20 masa dhe 11 masa mbeten në proces zbatimi. Janë vetëm 9 aktivitete (7 në proces dhe 2 të pazbatuar) të parashikuara në funksion të organizimit dhe zbatimit të 8 masave në proces zbatimi (10, 12, 16, 13, 19, 32, 35 dhe 41). Në përfundim, rezulton se 9 aktivitete të parashikuara për zbatim në 6-mujorin e parë të vitit 2024, kanë ndikuar në statusin final të masave 1, 6 dhe 18, të vlerësuara në proces zbatimi.

Gjatë vitit 2023, masa dhe aktivitetet e lidhura me miratimin dhe publikimin e Kodit të Etikës së institucionit të parashikuar për zbatim në periudhën korrik - dhjetor 2022, u realizuan brenda 3-mujorit të parë të vitit 2023. Gjithashtu plotësimi i Kodit të Etikës me disa rregulla të brendshme mbi lobizmin dhe hartimi i regjistrat për deklarimin e dhuratave janë parashikuar si aktivitetet 1/1 dhe 1/2 nën masën 1 të Planit të rishikuar të masave në kuadër të Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO dhe shkresës me nr. prot. 1363/7, datë 04.07.2023, dërguar nga Ministria e Drejtësisë. Bazuar në këtë Rekomandim janë shtuar edhe aktivitetet që lidhen me përditësimin e rregullores së brendshme sipas strukturës së miratuar të institucionit, si dhe përfshirjen e të gjithë funksioneve dhe punonjësve të institucionit, dhe anëtarëve të kabinetit të ministrit (aktiviteti 6/1), si dhe me hartimin e një pakete informuese dhe kryerjen e trajnimeve të anëtarëve të kabinetit për kuadrin rregulator (aktivitetet 18/1 dhe 18/2).

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit rregulator të brendshëm mbi aspekte të integritetit dhe aktiviteteve që përfshijnë menaxhimin financiar dhe proceset e punës sipas njësive të përbajtjes.

Nga ana tjetër, raporti evidenton plotësish nevojën për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm dhe në mënyrë të vazhdueshme të strukturave teknike (njësive të përbajtjes) dhe kapaciteteve profesionale të ministrisë në zbatim të parashikimeve të bëra përtë mundësuar një performancë më të mirë institucionale ndaj rreziqeve të integritetit.

Raporti evidenton gjithashtu rëndësinë e përmirësimit të mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve publike

## Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit për periudhën *janar-dhjetor* 2023, të kuadrit rregulator mbi aspekte të integritetit në MSHMS, të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve profesionale, si dhe çështje të transparencës institucionale dhe funksionimit me efikasitet të strukturave teknike të Ministrisë.

### Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 13 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtorisë TIK për MSHMS, me kontribut të një grupi punonjësish që janë pjesë përbërëse e drejtorive të Institucionit, për të cilët ka pasur të parashikuar masa për zbatim në periudhën *janar – dhjetor* 2023. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

## Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori<sup>1</sup> i Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- Drejtoria e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës;
- Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave;
- Drejtoria e Koncensioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve;
- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Drejtoria e Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Fushën e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore;
- Drejtoria e Zhvillimit të Politikave të Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimeve;
- Drejtoria e Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Drejtoria e Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik;
- Drejtoria e Politikave të Shërbimit Spitalor;
- Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij rapporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashkuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumente të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitet përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

---

<sup>1</sup> Koordinatori i Integritetit për MSHMS është Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve

## Gjetjet e Raportit

### ■ Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri


Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregulator.

Ky objektiv përmban një numër prej 5 masash specifike të planifikuara në 9 aktivitete për t'u zbatuar nga njësitet e përfshira, 1 prej të cilave është mbartur nga viti 2022. Masat specifike i referohen kuadrit rregulator të brendshëm të integritetit, kulturës së integritetit në institucion, si dhe ndërgjegjësimit dhe informimit vazhdimesh dhe rregullisht të punonjësve të institucionit mbi këto aspekte.

Njësitet raportuese për këtë objektiv janë strukturat teknike të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve; Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregulator dhe Drejtoria e Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit për MSHMS. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 3 masa të zbatuara plotësisht, 2 në proces zbatimi, 0 të pazbatuar.

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Kuadër rregulator për integritetin	Masa/ Aktivitete	5	3	2	-

Zbatimi i Masave dhe Aktiviteteve



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2023*, evidentohet se Kodi i Ri i Etikës i hartuar me kontribut të DMBNJ dhe Grupit të punës eshtë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 44, datë 26.01.2023 "Për miratimin e Kodit të Etikës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale". Kodi i Etikës të MSHMS, eshtë publikuar në faqen zyrtare të institucionit në linkun: <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2023/11/KODI-I-ETIKES-MSHMS.pdf>, rubrika publikime, programi i transparencës, kuadri ligjor rregullator, tekstet e plota, si dhe u eshtë shpërndarë me email të gjithë punonjësve të MSHMS, në 3 - mujorin e parë të vitit 2023. (**aktiviteti 1.1/ masa 1**).

Ky aktivitet ishte parashikuar për zbatim në përiudhën korrik-dhjetor të vitit 2022. Gjithashtu, plotësimi i Kodit të Etikës me disa rregulla të brendshme mbi lobizmin dhe hartimi i regjistrat për deklarimin e dhuratave të parashikuar për zbatim në 6 - mujorin e parë të vitit 2024, referuar aneksit të raportit si aktivitetet 1.1/1 dhe 1.1/2 nën masën 1, të Planit të masave të rishikuar në kuadër të Rekomandimit të GRECO, do të përbushë realizimin plotësisht të masës 1.

Planifikimi i nevojave për trajnim të punonjësve të institucionit nga ana e DMBNJ, sipas kërkësave dhe nevojave të evidentuara për trajnim, të çdo njësie të përbajtjes për vitin 2023, i eshtë përcjellë ASPA-s me anë të shkresës Nr. 4055/1 prot, datë 22.11.23. Kodi i Etikës së MSHMS të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë u eshtë shpërndarë me email të gjithë punonjësve të institucionit, si dhe 2 (dy) punonjës kanë ndjekur 2 (dy) sesione trajnimi online të organizuar nga ASPA. Gjithashtu në muajin shkurt 2023, eshtë zhvilluar trajnimi "Për modulin e etikës dhe integrititetit në Administratën Publike" ku morën pjesë 10 (dhjetë) punonjës nga MSHMS në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe këshilltarë të kabinetit të ministrit. (**aktiviteti 1.2/ masa 1**)

Gjatë kësaj priudhe, autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në DBNj, përcaktuar sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 37/1, datë 24.01.23, evidentohet se kanë kryer në vijimësi informimin mbi parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë punonjësit e MSHMS nëpërmjet emailit zyrtar, si dhe të çdo punonjësi të ri të punësuar në periudhën janar - dhjetor 2023 dhe të cilit i jepet për nënshkrim Autorizimi përkatës në momentin e lidhjes të kontratës së punës. Të gjithë punonjësve të aparatit të ministrisë u janë vënë në dispozicion të dy formularët: Deklarimi rast past rasti i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike dhe Deklarimi i konfliktit të vazhdueshëm të interesave. (**aktivitetet 3.1; 3.2/masa 3**)

Bazuar në kërkësat e punonjësve të institucionit, si dhe informacionit të dërguar nga ASPA evidentohet se plani i trajnimeve i hartuar për vitin 2023 nga punonjësit e strukturës së DMBNJ, ka përfshirë edhe temat e konfliktit të interesit dhe një trajnim për modulin e etikës dhe integrititetit në administratën publike. Në mënyrë të rregullt ASPA ka dërguar kalendarin e trajnimeve me bazë javore dhe punonjësit janë regjistruar paraprakisht. Përgjatë vitit 2023 janë trajnuar mbi 50 punonjës nga të gjithë drejtoritë e përbajtjes, për rreth 62 tema, përkatësisht: në 6-mujorin e parë të vitit 2023 - 25 punonjës për 30 tema dhe në 6-mujorin e dytë të vitit 2023 - 32 punonjës për 32 tema, që përfshijnë çështje të etikës dhe integrititetit në Administratën Publike, K-I, komunikimin dhe të drejtën për informim, ruajtjen e të dhënavë personale, prezantimi në administratën publike, gjuha e urrejtjes, parandalimi i ndikimit në institucionet publike; menaxhimi i burimeve njerëzore; konsultimi publik; mbrojtja nga diskriminimi, etj. (**masa 4**)

DMBNJ nëpërmjet emailit zyrtar, ka kryer në vijimësi informimin e punonjësve të MSHMS mbi rregullat e komunikimit dhe etikën e komunikimit duke u përcjellë me email kuadrin ligjor në fuqi dhe formatet përkatës. Dërgimi i kuadrit rregullator të brendshëm si rregullorja e brendshme e institucionit, kodi i etikës, rregullorja e

K-I dhe formateve përkatës, si dhe i Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm "Mbi formatet e hartimit të shkresave zyrtare". (**aktiviteti 5.1/masa 5**)

Në këtë periudhë raportimi, evidentohet se punojësit e institucionit përdorin OneDrive-n për të ruajtur çdo dokument, i cili mund të aksesohet nga kompjutera apo pajisje të ndryshme pa pasur nevojën ta ruash në një USB. OneDrive është një librari personale që lejon ruajtjen dhe organizimin e dokumenteve, ndarjen e tyre me bashkëpunëtorët, krijimin e versioneve dhe krijon mundësinë e aksesimit të tyre nëpërmjet web-it për të gjithë përdoruesit e krijuar në Domainin "gov.local". OneDrive është i konceptuar si një hapësirë ku përdoruesi mund të vendlodhi gjitha dokumentet e tij. Për aksesimin e kësaj librarie përdoruesi logohet me të njëjtët kredenciale që përdor për emailin zyrtar. (**aktiviteti 5.2/masa 5**)

Autoriteti Përgjegjës për parandalimin e K-I në MSHMS, të ngritur me Urdhër Ministri dhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, informon zyrtarët e rinj të ministrisë, se çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarim paraprak dhe rast përrast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak përrast lindjen e një konflikti interesit, si dhe të gjithë punonjësit nëpërmjet shpërndarjes rregullisht me email kujtues të kuadrit ligjor për parandalimin e K-I. (**aktiviteti 6.2/masa 6**)

Në Kreun II të Rregullores për parandalimin e K-I në MSHMS, përcaktohen procedurat dhe mjetet për identifikimin dhe rregjistrimin e Konflikteve rast pas rasti të Interesave. Gjithashtu Urdhri Nr. 731, datë 14.12.2023 ka miratuar formatin e Deklaratës së punonjësve të administratës së MSHMS pas lënies së detyrës për ndalimin e përdorimit të informacionit konfidencial të marrë gjatë kryerjes së detyrës për interes personal dhe përfaqësimit në konfliktet me MSHMS. (**aktiviteti 6.2/masa 6**)

Bazuar në sa më sipër, çdo punonjës, anëtar i grupeve të licencimit dhe/ose të monitorimit të kontratave koncessionare, në rast se ndihet në kushtet e K-I i drejtohet me shkresë eprorit të drejtpërdrejt ose DMBNJ të institucionit për plotësimin e formularëve më sipër. Aktualisht nuk ka formular tip për deklarimin e K-I nga anëtarët e këtyre grupeve. Në rast të ndryshimit të legjislacionit specifik për licencimin dhe/ose koncessionet do të përshtatet deklarata. Rastet e konfliktit të interesit rregullohen nga legjislacioni përkatës i fushës. Referuar Kodit të Procedurave Administrative të RSH, Neni 31, Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përashtim: 1. Nëse nëpunësi publik ose anëtarë i organit kolegjial të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30, të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij ose organin kolegjial. 2. Çdo nëpunës tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30, të këtij Kodi, njofton në përputhje me pikën 1 të këtij nenit. 3. Pala mund të kërkohë përashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtarë të organit kolegjial nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet përrast cilat kërkohet përashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në cilat ajo mbështetet. 4. Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimmarrës. Për sa më sipër aktiviteti është vlerësuar i realizuar dhe do të zbatohet në përputhje me ndryshimet ligjore për licencat dhe koncessionet. (**aktiviteti 6.1/masa 6**)

Ndonëse të dy aktivitetet 1.6.1 dhe 1.6.2 nën masën 6, të parashikuara për zbatim në përiudhën raportuese janë vlerësuar të zbatuar, realizimi në total i masës 6 është vlerësuar në proces zbatimi. Arësyja është planifikimi i 3 (tre) aktiviteteve nën masën 6/1, në kuadër të Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO, të cilët parashikohen për zbatim në 6-mujorin e parë të vitit 2024. Parashikimi plotësish i të gjithë funksioneve dhe punonjësve, përfshirë anëtarët e kabinetit të ministrit, sipas strukturës së miratuar, në rregulloren e institucionit do të përmbushë realizimin plotësish të masës 6, të planit të veprimit.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

## ■ Objktivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri


Përmes këtij objktivi synohet konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale të burimeve njerëzore aktuale dhe punonjësve të rinj që kanë aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për vendin e punës, si dhe me njohuri për aspekte të veçanta të integritetit, të cilët zbatojnë rregullat dhe procedurat e punës dhe janë të aftë të veprojnë sipas legjislacionit në fuqi duke marrë masa përmirësimi dhe parandalimi të K-I, sjelljeve joetike, mos-diskriminimit dhe mundësive të barabarta.

Ky objektiv përmban një numër prej 9 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitat e përfshira, të cilat i referohen 16 aktivitetave lidhur me njoftimet paraprake dhe në mënyrë të rregullt mbi procesin dhe afatet e vlerësimit të punonjësve, rregullat për dorëzimin e detyrës, zbatimit të rregullave të etikës dhe identifikimin e sjelljeve jo-etike në administratën publike, sinjalizimin, si dhe forcimit të kapaciteteve profesionale nëpërmjet planifikimit të nevojave për trajnim dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të punonjësve të drejtive të përbajtjes në trajnimet kombëtare dhe rajonale, specifike për fushën e përgjegjësisë. Bazuar në Rekomandimin ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO dhe shkresës me Nr. 1363/7 protokolli, datë 04.07.2023, dërguar nga Ministria e Drejtësisë, janë shtuar aktivitetet 18/1.1, 18/1.2 dhe 18/1.3 nën masën 18, të planit të veprimit, të parashikuar për zbatim në 6 – mujorin e parë të vitit 2024 e në vazhdim.

Njësitat e raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, Drejtorisë të Politikave të Shërbimit Spitalor; Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik; Drejtorisë së Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore; Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore; Drejtorisë së Programimit të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Drejtorisë së Jetësimit të Prioritetave dhe Statistikave; Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregulator; Drejtorisë së Integrimit Koordinimit Marrëveshjeve dhe Asistencës; Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 5 masa të zbatuar plotësish, 4 në proces zbatimi (në aneksin e raportit referuar si masat 10, 12, 16 dhe 18), dhe 0 të pazbatuar. Ndërsa aktivitetet e këtij objektivi mbeten 4 ende në proces zbatimi, referuar si aktivitetet 2.10.2, 2.12.2, 2.16 dhe 1 të pazbatuar referuar si aktiviteti 2.10.3 në aneksin e raportit. Masa 18 është vlerësuar në proces zbatimi, pasi aktivitetet 18/1.1, 18/1.2 dhe 18/1.3 janë parashikuar për zbatim në 6 - mujorin e parë të vitit 2024.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b>
Burime njerëzore të qëndrueshme dhe të kualifikuara	Masa/Aktivitete	9	5	4	-

Zbatimi i Masave dhe Aktiviteteve



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Sistemi i Burimeve Njerëzore për aparatin e ministrisë është i konsoliduar dhe njoftimet për procesin e vlerësimeve janë kryer sipas afateve të përcaktuara ligjore me shkresë zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm dhe nëpërmjet emailit zyrtar, lidhur me vlerësimet e punonjësve për 6-mujorin e parë të vitit 2023 dhe përcaktimin e objektivave të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2023, vlerësimin e ndërmjetëm dhe vlerësimin e punës për 6-mujorin e parë të vitit 2023, si dhe vlerësimet e punonjësve për 6-mujorin e dytë të vitit 2023 dhe përcaktimin e objektivave të punës për 6-mujorin e parë të vitit 2024. Shkresa me nr. 4769 prot., datë 15.12.2022 dhe emaili përcjellës i datës 17.01.2023; Shkresa me nr. 1719 prot., datë 19.04.23 dhe emaili përcjellës muaji prill 23, shkresa nr. 2321 prot., datë 14.06.2023 dhe emaili përcjellës muaji qershori 2023. Shkresa me Nr. 4689 prot., datë 21.12.2023. (**masa 7**)

Gjatë periudhës së raportimit Janar - Dhjetor 2023 nuk janë konstatuar sjellje jo-etike të punonjësve të MSHMS, bazuar në sondazhe spontane të DMBNJ. Model formati i pyetësorit për vlerësimin periodik të sjelljeve jo etike dhe jo profesionale në institucion është përgatitur nga DMBNJ, në pritje për miratim dhe i vlerësuar në proces zbatimi në aneksin e raportit si **aktiviteti 2.10.2**. Pas miratimit, pyetësori do të shpërndahet tek punonjësit e institucionit dhe DMBNJ do të kryejë analizën e gjetjeve, vlerësuar i pazbatuar në aneksin e raportit si **aktiviteti 2.10.3**. Zbatimi në tëresi i masës vlerësohet në proces zbatimi. (**masa 10**)

Rregullat për dorëzimin e detyrës janë përfshirë në rregulloren e brendshme të institucionit, si Shtojca A "Deklaratë e punonjësit të administratës së MSHMS, pas lënies së detyrës për ndalimin e përdorimit të informacionit konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal dhe përfaqësimit në konfliktet me MSHMS", të miratuar me Urdhrin nr.731, datë 14.12.2023 dhe zbatuar për 2 (dy) punonjës të cilët janë larguar nga institucioni në muajin dhjetor 2022. (**masa 11**)

Në datat 26-27 Prill 2023, janë organizuar trajnime nga Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri në bashkëpunim me SIGMA/OECD nën moderimin e Institutit për Demokraci dhe ASPA, për përmirësimin e proceseve RIA dhe të Konsultimit Publik 2023. Në përfundim, pjesëmarrësit 4 (katër) punonjës të MSHMS nga 3 (tre) drejtori të përbajtjes u pajisen me certifikatë nga ASPA. Gjithashtu, është zhvilluar një trajnim në klasë me temë "Hartimi legjislativ" i organizuar nga ASPA në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ku një ndër sesionet i është dedikuar edhe RIA-s. Kohëzgjatja e trajnimit ishte 27 orë, me 8 sesione prej 3 orësh, në periudhën 1 Qershori - 14 Korrik 2023. Pjesëmarrësit u pajisen me certifikatë pas sesionit coaching dhe testimit. Ftesat për të dy trajnimet janë dërguar me emailin zyrtar. (**aktiviteti 12.1/masa 12**)

Aktualisht, grupet e punës të cilët ngrihen për hartimin e një projektligji të caktuar, ngarkohen për të hartuar edhe paketën shoqëruese të projektaktit e cila përfshin edhe RIA-n. Ky aktivitet (**referuar si 2.12.2 në aneksin e raportit**) vlerësohet në proces zbatimi, pasi detyra për hartimin e dokumentit të RIA-s edhe pse aktualisht zbatohet nga anëtarët e grupeve të punës, nuk është e cilësuar në urdhër si një detyrë specifike e anatarëve të grupeve të punës që hartojnë projektaktin dhe paketën shoqëruese. (**masa 12**)

Drejtoria e Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregulator është e ndarë në tre sektorë: Sektori i Hartimit, Harmonizimit dhe Monitorimit të Akteve Rregulatorë, Sektori i Këshillimit Ligjor dhe Sektori i Lejeve dhe Licencave. Secili nga këta sektorë ka detyra të dallueshëm nga njëri tjetri, të cilët janë të përcaktuar në Rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe janë reflektuar edhe në formularin e përshkrimit të punës për çdonjërin nga punonjësit e sektorit, përgjegjësin dhe dy specialistët. Konkretisht, Sektori i Hartimit të Akteve Rregulatorë ka për detyrë kryesore të koordinoje procesin dhe cilësinë e hartimit të projektakteve rregulatorë brenda fushës së përgjegjësisë së MSHMS, ndërkohë që Sektori i Këshillimit Ligjor ka si detyrë kryesore menaxhimin e procedurave gjyqësore ku MSHMS është palë. (**masa 13**)

Sektorët e përbajtjes të Drejtorisë së Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës punojnë sipas objektivave dhe përshkrimit të punës të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit dhe në mbështetje të kuadrit rregulator specifik sipas fushës së përgjegjësisë.

Në këtë kuadër, stafi përgjegjës ka koordinuar punën me të gjithë antarët e GNP-ve të MSHMS për të kontribuar me materialet e kërkua nga zyra e Kryenegociatores duke përbushur çdo kërkesë për çështjet e Integrimit Evropian, duke respektuar fazat e procesit si punën përgatitore, planifikimin, hartimin dhe kontrollin e cilësisë, konsultimin dhe miratimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

Stafi i njësisë përgjegjëse për IPA-t në MSHMS, të përditësuar me Urdhër të Ministrit, ka kryer raportimet sipas formularëve përkatës. Në kuadër të zhvillimit të burimeve njerëzore, trajnimet e kryera nga punonjës të drejtorisë së përbajtjes janë: 1) Technical Assistance to Strength the Capacities for the overall planning, preparation and implementation of infrastructure projects in Albania, më datë 23.09.2022, mbështetur nga HILL International; 2) Interreg IPA South Adriatic

2021-2027, më datë 22.11.2022 dhe mbështetur nga Agjencia shtetërore e programimit strategjik dhe koordinimit të ndihmës (SASPAC), më datë 22.11.2022; 3) Seminari: Procedurat e Besimit për Programet Vjetore të Veprimit të finançuara nga Programi IPA III dhe organizuar nga MFE, më datë 05.05.2023.

Në bazë të vendimit Nr.420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e ceremonialit shtetëror në Republikën e Shqipërisë", janë kryer detyra protokollare si: pritje, përcjellje e delegacioneve të huaja në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve mbështetëse në MSHMS. **(masa 14)**

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zvoglimin e Riskut nga fatkeqësitet 2023 – 2030 dhe Planit të veprimit, Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitet në Nivel Qëndror, si dhe të Hartimit të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), është dërguar shkresa me lëndë "Njoftim mbi identifikimin e nevojave institucionale për trajnim në fushën e mbrojtjes civile" dhe Formulari i plotësuar, në pritje për t'u dërguar nëpërmjet platformës elektronike (jo funksionale) të AKMCA, përmban temat e trajnimit të identifikuara dhe që do të kontribojnë në rritjen e njohurive, kompetencave dhe aftësive për çështjet e mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitet, të punonjësve që përfshijnë këto çështje në MSHMS dhe institucionet e varësisë. Programi i trajnimeve nga strukturat e AKMC-së nuk ka filluar të implementohet dhe masa vlerësohet në proces zbatimi.

Nga ana e AKMC-së dhe konsulentëve nga Agjencia Suedezë e Kontigjencave Civile së fundmi është bërë prezantimi i Projektit "IPA Care". Objektivi i përgjithshëm i këtij Projekti është të kontribojë në rritjen e rezistencës në vendet partnere ndaj tërmeteve dhe emergjencave të veçanta shëndetësore duke kombinuar Mbrotjen Civile me Emergjencat Shëndetësore. Në këtë fazë të parë të Projektit po kërkohet të identifikohen nevojat dhe kapacitetet nëpërmjet identifikimit të Pikave fokale në Shqipëri (përfaqësues nga Institucionet qendrore dhe të varësisë). MSHMS ka kërkuar nga ISHP dhe QKUM identifikimin e personave të kontaktit lidhur me kërtë çështje. **(masa 16)**

Punonjës të Drejtorisë së Politikave të Shërbimit Spitalor, të Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik, Drejtorisë së Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore; të Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore dhe të Drejtorisë së Zhvillimit të Përkujdesit Shoqëror, evidentohet se kanë ndjekur trajnimet në kurset online me temë:

- Politikat Publike
- Standardizimi i hartimit të dokumenteve strategjik;
- Hartimi dhe miratimii akteve ligjore në BE;
- Institucionet komunitare dhe me pushteti vendimarrës në BE;
- Lëvizja e lirë në BE;
- Azili në Bashkimin Evropian dhe rregullat për përsitimin e bashkimit familjar;
- Përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit;
- Harmonizimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-SDG) me politikat kombëtare në kuadër të planifikimit strategjik.
- Shëndeti si një koncept në zhvillim, përcaktuesit shoqërorë globalë të shëndetit
- Menaxhim projekti.

Në vijimësi, për periudhën raportuese punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, kanë ndjekur sesione trajnimesh online të organizuara nga ASPA, mbi çështje sipas fushës së përgjegjësisë: WHO training on hospital response plan development in Balkans (4 punonjës); Shëndeti si një koncept në zhvillim, përcaktuesit shoqërorë (globalë) të shëndetit, (1 punonjës); Lëvizja e lirë e mallrave, (1 punonjës); Shërbimet dhe tregu digjital (1 punonjës); Drejtësia, liria dhe siguria - 4 punonjës; Sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale (2 punonjës); Rregullat e vendosura nga vendet e Bashkimit Evropian për refugiatët dhe azilkërkuesit (2 punonjës); Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përafrimi me direktivat e BE (1 punonjës); Nocioni i diskriminimit në Administratën Publike (9 punonjës); Parandalimi dhe adresimi i dhunës dhe ngacmimit seksual në vendin e punës (2 punonjës); Antixhipizmi-Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes kundrejt Romëve dhe Egjiptianëve (2 punonjës); Menaxhimi i ujit të pijshëm, për parandalimin, kontrollin dhe ndikimi në sëmundjet ngjitime që lidhen me ujin (3 punonjës); Cilësia e ujrale bregdetarë, larës dhe rëndësia në zhvillimin e turizmit (3 punonjës); Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në nivel vendor (2 punonjës); Buxhetimi gjinor për pakicat rome dhe egjiptiane (1 punonjës).

Gjithashtu punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, kanë ndjekur kanë marrë pjesë në veprimitari të ndryshme, sipas çështjeve që mbulojnë, të organizuara brenda dhe jashtë vendit, në cilësinë e pjesëmarrësve, trajnerit apo moderatorëve, të tilla si:

- Trajnim “Shërbimet komunitare të shëndetit mendor në vendet anëtare të rrjetit”, organizuar nga rrjeti i shëndetësisë për Europën Juglindore, në Trieste, Itali;

- Trajnim mbi përgatitjen e pozicionit negocues për Kapitullin 23, organizuar nga Ministria e Drejtësisë;

- Trajnim mbi saktësimin e treguesve/indikatorëve dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik Romalb, në periudhën nëntor-dhjetor 2023. Në trajnim morrën pjesë 137 pjesëmarrës, përdorues të siatemit Romalb. Ky trajnim përmbylli ciklin e trajnimeve me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, me mbështetjen e UNDP.

- Trajnim mbi menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, në datat 1-2 Nëntor 2023. Në trajnim morrën pjesë 61 kordinatorë vendorë për menaxhim e dhunës në familje.

- Workshopi mbi eliminimin e diskriminimit ndaj personave LGBTQI në sektorin privat në Shqipëri, në datën 19 dhjetor 2023.

- Trajnim me temë “Hartimi legjislativ”, i zhvilluar në klasë, i ndarë me 8 sesione nga 3 orë secila. Në total 27 orë trajnim i zhvilluar në periudhën 1 Qershori -14 Korrik 2023;

- Workshopi me temë “Improving regulatory impact assessment (RIA) and public consultation policies: Key challenges and next steps in reforms” organizuar në muajin prill 2023, në tre ditë;

- Kursi online i organizuar nga Universiteti i Ghent me temë “Përshtpjektimi i zbatimit të strategjive kombëtare të të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues dhë planeve të veprimit në rajonin e Europës Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore, lidhjen e provave, politikave dhe praktikës.

- Workshop për rishikimin e standardeve të shërbimeve sociale rezidenciale për fëmijët 0-6 vjeç, të mosuarit dhe viktimat e trafikimit;

- Workshop për rishikimin e standardeve të shërbimit ditor për PAK;

- Workshopi “Zhvillimi i shërbimeve sociale në nivel vendor”, në kuadër të programit TAIEX;

- Shërbimet sociale të integruara për familjen, fëmijët, prindërit, të rinjtë, të moshuarit, në Bern, Zvicër;

- Vizitë studimore në Qendrën për mbrojtjen e fëmijëve, Zagreb, Kroaci, muaji Tetor 2023;
- Workshopi “Mbështetja e strukturave të administratës shtetërore për shkrimin e ERP-së”, në kuadër të programit TAIEX , në muajin Nëntor 2023. (**masa 17**)

Hetimi i Sinjalizimit vijon të kryhet nga DAB. Tek recepsioni në hyrje të institucionit vijon të jetë i afishuar njoftimi mbi personat e kontaktit të cilët do merren me hetimin administrativ të sinjalizimit. Baza ligjore dhe formularët tip mbi sinjalizimin janë dërguar rregullisht, me email, çdo vit, tek punonjësit e institucionit dhe punonjësit e rinj. Gjithashtu, punonjësit e MSHMS janë të informuar në vijimësi nëpërmjet emailit zyrtar edhe mbi linkun e publikimit të dokumenteve mbi sinjalizimin. Nëpërmjet Drejtorisë TIK të MSHMS është bërë publikimi i bazës ligjore për sinjalizimin në faqen zyrtare të MSHMS, si më poshtë (**masa 18**):

<https://shendetesia.gov.al/rregullore-dokumenta-udhezues/>  
<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2023/01/FORMULAR-I-SINJALIZIMIT-T%C3%8B-BRENDSH%C3%8BM-1.doc>;  
<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2023/01/FORMULAR-I-SINJALIZIMIT-T%C3%8B-JASHT%C3%8BM-1.doc>;  
<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2023/01/REGJIST%C3%8BR-I-K%C3%8BRKES%C3%8BS-P%C3%8BR-MBROJTJEN-NGA-HAKMARRJA-1.xls>;  
<https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2023/01/FORMULAR-K%C3%8BRKES%C3%8B-P%C3%8BR-MBROJTJE-NGA-HAKMARRJA-1.doc>;

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


### ■ Objktivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënavë me publikun

Përmes këtij objktivi synohet transparenca e ministrisë gjatë procesit të zbatimit të politikave përmes rritjes së pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm të sektorit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të publikut në tërësi.

Ky objektiv përban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira. Masat specifike i referohen 5 aktivitetave specifike si: forcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik, si dhe ofrimit të vazhdueshëm të informacionit për publikun nëpërmjet Platformës së Transparencës si: publikimit të përbledhjes së raporteve të monitorimit të kontratave koncesionare në PT të MSHMS, hartimit të formave lehtësuese për paraqitjen e ankesave, problemeve dhe publikimit në faqen web të ministrisë, funksionimit të sistemit (platformës) EDRMS, si dhe sistemimit e marrjes në dorëzim të fondit të arkivit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore; Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve; Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 3 masa të zbatuara plotësisht, 1 në proces zbatimi, 0 të pazbatuar.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Transparenca e MSHMS	Masa/ Aktivitete	4	3	1	0



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Evidentohet se Sektori i Çështjeve Juridike Administrative ka hartuar formatin “Kërkesë ankesë”, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Është në proces miratimi i formatit për “Vërtetimin e dorëzimit të ankesave/kërkesave” të publikut në institucion dhe masa vlerësohet në proces zbatimi (**masa 19**).

Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve në MSHMS plotëson informacionin e kërkuar nga germa (e) të nenit 7, të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Platformën e Transparencës në rubrikën: Informacion mbi procedurat e prokurimit/procedurën konkurruese të koncessionit/partneritetit publik privat/ Lista e kontratave të lidhura (kopje të secilës) të anomizuar sipas parashikimeve ligjore në weblinkun <https://shendetesia.gov.al/programi-i-transparences-5/> (**masa 20**)

Evidentohet se Fondi Arkivor i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është marrë në dorëzim me proces verbalin me nr. 1271 prot., datë 16.2.2018, si dhe punonjësja me kohë të pjesëshme është bërë pjesë e punonjësve me kohë të plotë në pozicionin “specialist në sektorin e arkiv protokollit”, në muajin korrik 2023. (**masa 23**)

Evidentohet gjithashtu se sistemi EDRMS është vënë në funksion në muajin Janar 2024, si dhe është shpërndarë manuali i përdoruesit për çdo punonjës nëpërmjet emailit zyrtar. Bazuar në udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm, specialistët e Drejtorisë TIK në MSHMS mbështesin

punonjësit dhe mbarëvajtjen e sistemit në çdo zyrë, në vazhdimësi. Pas hakerimit të sistemeve në muajin korrik 2022, u shtua “Sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik”, në vijim i quajtur “SQDNE”, sistem i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrmin e shërbimit, aplikimi i të cilët realizohet nëpërmjet platformës “e-Albania”, deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrit të shërbimit sipas afateve ligjore. (**masa 24**)

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

#### ■ Objktivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar


Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe monitorimit për investime dhe projekte të ndryshme në fushën e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe marrjes së masave parandaluese për të mbrojtur investimet e bëra.

Ky objektiv përmban një numër prej 5 masash specifike të planikuara për t'u zbatuar nga njësítë e përfshira. Masat specifike të cilat i referohen 6 aktiviteteve si organizimit të trajnimeve mbi menaxhimin e programeve dhe PBA-në të dedikuara për EMP- të në ministri, përditësimit të regjistrat të rezikut në mënyrë sistematike në ministri, certifikimit të stafit të auditit të brendshëm, informacionit mbi problematikën në dhe vlerësimit mbi ndryshimin e VKM-së mbi Auditimin e strukturave spitalore.

Njësítë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Dejtorisë së Auditit të Brendshëm; të Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator; dhe Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 3 masa të zbatuara plotësisht dhe 2 në proces zbatimi referuar si masat 28 dhe 32. Ndërsa aktivitetet e këtij objektivi mbetet 1 i pazbatuar, referuar si aktiviteti 32.2 në aneksin e raportit.

Objktivi 5	Masat dhe Aktivitet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitetet pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Planifikimi, Monitorimi dhe Kontrolli i Brendshëm i MSHMS	Masa/ Aktivitete	5	3	2	0

### Zbatimi i Masave dhe Aktiviteteve



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Përgjatë vitit 2023, evidentohet se dy punonjës të sektorit të përmbajtjes kanë ndjekur trajnimin në kursin online me temë: "Buxhetimi i përgjithshëm gjinor në politikat publike", të organizuar nga ASPA, në datat 30 maj-13 qershor. Trajnim u zhvillua në seancë 3 orëshe, në 5 ditë dhe në fund u pajisën me çertifikatë. Gjithashtu të njëjtët punonjës, specialistë të sektorit të përmbajtjes kanë ndjekur trajnimin online, me temë: Programi buxhetor afatmesëm dhe monitorimi i tij. Trajnim i zhvilluar në 8 ditë në periudhën kohore 23 Maj - 26 Qershor 2023, me sesione nga dy orë secili. Gjithashtu, një specialist i sektorit ka ndjekur kursin online "Bazat në statistikë". Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2023, evidentohet se përgjegjësi i sektorit ka kryer trajnimet me temë: Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga njësítë e qeverisjes së përgjithshme dhe raportimi në Ministrinë e Financave dhe Menaxhimi i ndryshimit në Administratën Publike. Gjithashtu raportohet se përgjegjësi i sektorit, në muajin mars 2022 ka ndjekur trajnimin "Menaxhimi i rriskut" dhe në periudhën shkurt-mars 2022 "Programi i trajnimit CIPFA-s për kontabilitetin dhe raportimin financier në sektorin publik sipas sistemit IPSAS". (**masa 27**)

Dokumenti i PSV për proceset e punës që kryen Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar është hartuar nga përgjegjësi i sektorit si detyrë e një cikli trajnimesh organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Dokumenti duhet miratuar nga eprorët e hierarkisë administrative të institucionit dhe është vlerësuar në proces zbatimi. (**masa 28**)

Në zbatim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, MSHMS ka përditësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë regjistrin e riskut sipas drejtive të përmbajtjes. Shkresa me Nr. 1056 prot., datë 28.02.2023. (**masa 29**)

Bazuar në Programin Vjetor të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional të AB, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, stafi i njësisë përgjegjëse të Auditit të Brendshëm të MSHMS ka ndjekur trajnimet për vitet 2022 dhe 2023, sipas dokumentacionit verifikues dhe në përpunhje me kuadrin ligjor në fuqi. Emaile të datave 20.04.2023 dhe 21.10.2021; Urdhri Nr. 295,

datë 27.02.2023 dhe shkresa nr. prot., 3917, datë 27.02.2023 dërguar nga MFE; Urdhri Nr. 248, datë 31.12.2021 "Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vlijueshmë Profesional të AB në sektorin publik për vitin 2022". (**masa 31**)

Drejtoria e Auditit të Brendshëm në MSHMS, ka përgatitur një Memo për Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator ku vërehet mënyra e kryerjes së Auditimit të strukturave spitalore bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, kapacitetet njerëzore të strukturave audituese në MSHMS, FSDKSH dhe OSHKSH, si dhe propozimet për përmirësimin e auditimit të këtyre strukturave, që konsiderohen me rrisk të lartë. Mbetet për t'u vlerësuar propozimet e DAB lidhur me ndryshimet në kuadrin rregullator në fuqi që përfshin auditimin e spitaleve publike, të parashikuar për zbatim në përiudhën e raportimit dhe masa vlerësohet në proces, për shak të moszbatimit të **aktivitetit 2.32.2** referuar aneksit të raportit. (**masa 32**)


■ Objktivi 5: Përmirësimi i efikasitetit, transparencës dhe llogaridhëniec në sektorin e Shëndetësisë

Përmes këtij objktivi synohet forcimi i kontrolleve operativ të integritetit në fushat e planifikimit, vendimarrjes, monitorimit dhe projekteve në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, nëpërmjet hartimit dhe monitorimit të politikave të mbështetura tek instrumente metodologjike, procedura të qarta e të përshtatshme dhe në rritjen e transparencës.

Ky objektiv përmban një numër prej 8 masash/aktivitete specifike të planifikuar për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilët i referohen ofrimit të trajnimeve të veçanta për monitorimin dhe raportimin e veprimtarive me barnat narkotike për punonjësit e sektorit të farmaceutikës, publikimit dhe përditësimit të listës së produkteve kozmetike dhe pajisjeve mjekësore, hartimit të raporteve dhe evidentimit rregullisht të analizës së programeve mbi përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së fëmijëve.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë kryesisht strukturat që prodhojnë raporte dhe konkretisht struktura e drejtorisë së Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore, Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik, Kordinatori për të drejtën e informimit, dhe DMBNJ. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 6 masa të zbatuara plotësisht, 2 masa në proces zbatimi (në aneksin e raportit: **masat 5.35, 5.41**), 0 masë e pa zbatuar.

Objktivi 5	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitetet <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete <b>të parealizuara</b>
Efikasiteti, Transparencya dhe Llogaridhënia në MSHMS	Masa/ Aktivitete	8	6	2	-



Ķostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Nga raportimi rezulton që nëpunësit e drejtorisë së politikave farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore kanë kryer trajnime në vendin e punës të punonjësve të rinj nga punonjësit me përvojë mbi monitorimin dhe raportimin e veprimtarive me barnat narkotike, si dhe trajnime të ofruara nga SIDI dhe GIZ në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, në Bashkimin European në kuadër të mbështetjes së përgatitjes së grupeve negociatore për takimet bilaterale, Kapitulli 1- Lëvizja e Lirë e Mallrave Një punonjës ka marrë pjesë në takimin e Expertëve të Ballkanit Perëndimor për Drogat, në Bruksel, më datë 25 maj 2023 dhe një punonjës tjetër ka ndjekur sesionin online “Lëvizja e lirë e mallrave në BE”, organizuar nga ASPA. Kjo masë vlerësohet e realizuar. (**masa 34**)

Është realizuar pjesëmarrja e personave përgjegjës për raportim në takime bilaterale të organzuara në Bruksel në kuadër të Integrimit European. Drejtori i drejtorisë ka marrë pjesë në takimin e Expertëve të Ballkanit Perëndimor për Drogat, në Bruksel, më datë 25 Maj 2023. Përmenden gjithashtu, Takime Mock Exercise të shoqëruara me komente nga ekspertë të GIZ në lidhje me Draft-prezantimet për Kapitullin 1 - Lëvizja e lirë e mallrave (31 janar-2 shkurt 2023) në Bruksel, 2 pjesëmarrës njëri prej të cilëve online; dhe për Kapitullin 28 - Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndeti publik (16-17 shkurt 2023 në Bruksel, 3 pjesëmarrës; Webinari në lidhje me krizën e opioideve më datë 21.03.2023 (1 specialist online); Sesioni Coaching për anëtarët e GNPIE-së së Kapitullit 1, më datë 14 korrik 2023 në ambientet e GIZ; Takimi i GNPIE për Kapitullin 1, i zhvilluar më 30 tetor 2023, në ambjentet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Nënkomiteti Tregtia, industria, doganat dhe tatimet, më datë 15 nëntor 2023, në Hotel Tirana. (**masa 36.**)

Bazuar në matricën e projektakteve të MSHMS për vitin 2023, të miratuar me Urdhrin Nr.18, datë 16.01.2023 dhe në kuadër ndryshimeve të Ligjit 105/14 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" i ndryshuar janë listuar 8 projektakte që rrjedhin si detyrim i përditësimit të ligjor për barnat dhe shërbimin farmaceutik, nga të cilët vetëm një është në proces miratimi. Grupet ndërinstitucionale të punës të përcaktuara në Urdhër Ministri, kanë zhvilluar takime në MSHMS, si për ndarjen e detyrave ashtu dhe në konsultimin e drafteve paraprake, si dhe komunikime online lidhur me mendimet apo propozimet e ndryshme gjatë hartimit të projektakteve. Të gjithë projektatet janë

miratuar me VKM/Urdhër dhe një është në proces miratimi. Masa është vlerësuar në proces zbatimi, ndonëse e realizuar në masën 88%. (**masa 35**)

Për të gjitha autorizimet e lëshuara nëpërmjet sistemit on-line afati ligjor për lëvrimin e shërbimit është 28 ditë, përvèç “Autorizimit për tregtimin me shumicë/pakicë dhe/ ose prodhimin e barnave narkotike dhe lëndëve psikotrope” për të cilin afati kohor për lëvrimin e shërbimit është 90 ditë. Në zbatim të kësaj mase janë miratuar gjithashtu kriteret e licensimit të subjekteve me V.K.M. Nr. 227, datë 13.4.2022 për “Përcaktimin e kushteve specifike të licencimit, dokumenteve shoqëruese, procedurave të shqyrtimit, vlefshmërisë, procedurave të pezullimit dhe të shfuqizimit të licencës për prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë” për licensat:

1. Tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore
2. Prodhim i pajisjeve mjekësore

Afati i shqyrtimit të aplikimeve të mësipërme është 25 ditë.

Gjithashtu, në kuadër të trajnimeve të ofruara nga ASPA bazuar në kërkesat e punonjësve të institucionit, një specialist i drejtorisë ka marrë pjesë në trajnimet me temë: “Sistemi i menaxhimit të aplikimeve”. (**masa 37**)

Bazuar në kuadrin rregulator në fuqi për produktet kozmetike, njësia përgjegjëse në MSHMS dërgon tek ISHSH nëpërmjet emailit zyrtar dhe në mënyrë të rregullt bazën e të dhënavë të përditësuara të subjekteve që njoftojnë mbi produktet kozmetike që do të vendosen në treg. Një punonjës i drejtorisë (përfitues i programit kombëtar të praktikave të punës) është trajnuar për: “Shërbimet dhe tregu digital”, sesion trajnues i ofruar online nga ASPA. (**masa 38**)

Lista e pajisjeve mjekësore përditësohet rregullisht nga AKBPM. Referenca linku: <http://akbpm.gov.al/publikime/>. (**masa 39**)

Sektori i Kujdesit për Nënën dhe Fëmijën në objektivat e tij ka hartimin e raporteve me të dhënat e marra nga institucionet e varësisë dhe evidentimin e problematikave dhe politikave që duhet të ndërmerren në vijim. Politikat përfshirë politikat për vaksinimin e fëmijëve, për mirëushqyerjen dhe për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo shfrytëzimit.

Për sa më sipër MSHMS në bashkëpunim me UNICEF ka ngritur sistemin e monitorimit të praktikave të ushqyerjes dhe të rritjes së fëmijëve 0-5 vjeç në Shqipëri.

Ky proces synon të mbështesë fuqizimin e mekanizmave që sigurojnë cilësi, për të përmirësuar monitorimin e indikatorëve të ushqyerjes së fëmijëve në Shqipëri, nëpërmjet të dhënavë administrative. Sistemi i raportimit online të të dhënavë ka filluar të përdoret në të gjithë Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në vend. Pas monitorimit të të dhënavë të marra nga ky sistem u vu re se është e nevojshme të kryhen disa ndërhyrje si më poshtë:

- i. Ndërhyrje në softëare;
- ii. Trajnine rifreskuese mbi përdorimin e softëar-it, për NJVKSH e përfshira;
- iii. Supervizim i vazhdueshëm.

Gjatë 6 muajorit të dytë të 2023 janë kryer vizita supervizuese në të gjitha NJVKSH-të e Shqipërisë në kuadër të mbështetjes së Sistemit të Monitorimit të Rritjes dhe Praktikave të Ushqyerjes tek Fëmijët 0-5 vjeç. Raporti për këtë sistem do të hartohet në periudhën mars-prill 2024 pasi të mblidhen të gjitha të dhënat për vitin 2023 dhe masa vlerësuar në proces zbatimi. (**masa 41**)

Si pjesë e sistemit të survejances së obezitetit të fëmijëve në Shqipëri, që mbledh, analizon, interpreton dhe shpérndan informacion dhe ndihmon në monitorimin e mbipesës dhe obezitetit tek fëmijët, si dhe përdorimin e këtij informacioni për të kuptuar qartë ecurinë dhe për të planifikuar dhe ndërmarrë veprime në përputhje me situatën, është kryer studimi “Vlerësimi i obezitetit në moshën fëminore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në rutinën e përditshme dhe sjelljet e fëmijëve të moshës shkollore në Shqipëri” 2022 – 2023. Nga ky studim mblidhet gjithashtu informacion edhe mbi iniciativat aktuale të shkollës për të promovuar një mënyrë jetese (përfshirë ushqyerjen) të shëndetshme. Për herë të parë ky studim ofron informacion mbi sjelljet e fëmijëve në lidhje me aktivitetin/mosaktivitetin fizik, zakonet e të ngrënët, sjelljet dhe rutinat e përditshme, mirëqenien dhe sfondin e familjes gjatë COVID- 19 (periudha pandemike).

Për indikatorë të shendetit mendor dhe të dhunës ndaj fëmijëve janë zhvilluar sesione informuese me mësues dhe stafe nga sektorë të ndryshëm në të 12 (dymbëdhjetë) qarqet.

Gjithashtu janë zhvilluar raunde të sesioneve trajnuese për forcimin e kapaciteteve të personelit shëndetësor në shkollat e Tiranës mbi “Shëndetin Seksual dhe Riprodhues” dhe “Aktiviteti fizik dhe përfitimet e tij në shëndetin tonë”.

Gjatë periudhës së raportimit evidentohet miratimi i “Normave ushqimore për fëmijët 0-18 vjeç që trajtohen në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror” me urdhrin Nr. 465/1 datë 25.10.2022 të Zëvendësministrit të Shëndetësisë, dhe të cilët janë dërguar pranë SHSSH për zbatim në institucionet rezidenciale që përfshijnë këtë grupmoshë.

Përgjatë periudhës janar - dhjetor 2023 ka vijuar zhvillimi i sesioneve informuese me fëmijët dhe prindërit mbi ushqyerjen e shëndetshme në kuadër të projektit "Shkollat për Shëndetin" në qarqet Durrës, Lezhë, Berat, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër.

Studimi “Sjelljet e shëndetshme tek fëmijët e moshës shkolllore 11, 13 Dhe 15 vjeç (HBSC), është një studim i përbashkët ndërkombëtar i OSHSH-së për shëndetin dhe mirëqenien e adoleshentëve, përfshirë edhe fushën e ushqyerjes, që ndërmerr çdo katër vjet duke përdorur një pyetësor vetë-raportues për të marrë njohuri të reja për shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve, kuptuar përcaktuesit socialë të shëndetit, si dhe ndërmarrë politikat dhe praktikat informuese për të përmirësuar jetën e të rinjve. Rezultatet e studimeve të kryera orientojnë drejt nevojës për ngritjen e grupit të përbashkët të punës me MAS, ISHP, OSKSH për hartimin e udhëzuesve për një ushqyerje të shëndetshme për të gjithë grupmoshat, si dhe aplikimi i normave ushqimore për fëmijët e grupmoshës 0-18 vjeç në institucionet rezidenciale, nën monitorimin e SHSSH. (**masa 42**)

## Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën reportuese *janar - dhjetor 2023*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit 2022-2025, të rishikuar sipas rekomandimeve të GRECO.
- Është plotësuar kuadri rregullator për etikën dhe integritetin si rregullorja e brendshme e institucionit, rregullorja e brendshme për parandalimin e K-I, Kodi i Etikës së institucionit.
- Rregullat për dorëzimin e detyrës janë përfshirë në rregulloren e brendshme të institucionit, si Shtojca A.
- Aplikuar rregullisht njoftimi i punonjësve mbi sinjalizimin dhe njësinë përgjegjëse për hetimin administrativ.
- Aplikuar rregullisht njoftimi i punonjësve mbi kuadrin rregulator në fuqi për Etikën dhe Integritetin, përfshirë edhe K-I, autoritetin përgjegjës për K-I, komunikimin dhe etikën e komunikimit, vlerësimin e performancës.
- Njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë kanë shënuar përparime kryesishët në forcimin e kapaciteteve të stafit, të stafit të ri të rekrutuar, si në identifikimin e nevojave për zhvillimin me integritet të burimeve njerëzore të institucionit dhe në planifikimin e trajnimeve specifike të stafit të institucionit.
- Ndjekja në vijimësi e zbatimit të planit të trajnimeve për punonjësit e MSHMS për vitin 2023, bazuar në nevojat për zhvillim profesional dhe sigurimit të ofrimit të trajnimeve specifike në përputhje me proceset e punës.
- Pjesëmarrje e punonjësve të drejtorive të përbajtjes së politikave shëndetësore dhe mbrojtës/përfshirje sociale në aktivitete brenda dhe jashtë vendit sipas përgjegjësisë dhe çështjeve që mbulojnë.
- Përmirësim i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes së punonjësve në trajnimet mbi menaxhimin e programeve dhe PBA-në të dedikuara për EMP- të në ministri, përditësimit të regjistrit të rrezikut në mënyrë sistematike në ministri, certifikimit të vazhduar të stafit të auditit të brendshëm.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit [www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al) dhe Platformën e Transparencës si: publikimit të përbledhjes së raporteve të monitorimit të kontratave koncesionare në PT të MSHMS, hartimit të formave lehtësuese për paraqitjen e ankesave, problemeve dhe publikimit në faqen web të ministrisë, funksionimit të sistemit (platformës) EDRMS, si dhe sistemimit e marrjes në dorëzim të fondit të arkivit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

### Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e masave sipas parashikimeve në planin e veprimit.
- Të plotësohet kuadri rregullator për etikën dhe integritetin me përfshirjen e të gjithë funksioneve, punonjësve dhe funksionarëve të lartë politikë sipas strukturës së miratuar të institucionit.
- Të vijohet rregullisht me njofimet e stafit dhe stafit të ri lidhur me aspekte të integritetit në administratën pubike, sinjalizimin, K-I, procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve, etj.

- Të ndiqet zbatimi i trajnimeve të planifikuara të stafit të MSHMS-së për vitin 2024, me fokus rregullat e etikës dhe integrititetit në administratën publike, si dhe nevojat specifike të drejtorive të përbajtjes.
- Rast pas rasti të identifikohen qartësisht punonjësit që do të përfshihen në procesin e VNR dhe hartimi i VNR të cilësohet tek detyrat e grupeve të punës që hartojnë projektaktin dhe paketën shoqëruese.
- MSHMS të sigurojë pjesëmarrjen e pikave fokale në trajnimin për rritjen e rezistencës nga tërmetet dhe emergjencave të veçanta shëndetësore, që do të organizojë AKMC në kuadër të projektit IPA CARE.
- Të miratohet formati për vërtetimin e dorëzimit të ankesave/kërkesave të publikut në institucion.
- Të miratohen/formalizohen PSV për proceset e punës që kryen Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.
- Të propozohet ndryshimi në kuadrin rregulator lidhur me auditimin e spitaleve.
- Të finalizohet plotësimi i kuadrit rregulator për barnat dhe shërbimin farmaceutik.
- Të publikohet raporti dhe rekomandimet mbi praktikat e ushqyerjes së fëmijëve 0-6 vjeç.
- Të evidentohet rregullisht analiza e programeve mbi përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së fëmijëve.